



РЕПУБЛИКА СЕРБСКА МАКЕДОНИЈА - РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНИСË СË ВЕРИУТ
ЈАВНО ПРЕТПРИЈАТИЕ ЗА ДРЖАВНИ ПАТИШТА
НДËРМАРРЈА ПУБЛИКЕ ПËР РРУГË СШТЕТËРОРЕ

Бр.-Nr. 02-12935/5

28-12-2023 20 год.-viti
СКОПЈЕ - ШКУР



НДËРМАРРЈА ПУБЛИКЕ ПËР РРУГË СШТЕТËРОРЕ

ПРОГРАМИ ВЈЕТОР ПËР НДËРТИМ, РИКОНСТРУИМ, РЕХАБИЛИТИМ, МИРËМБАЈТЈЕ
ДНЕ МБРОЈТЈЕ ТË РРУГËВЕ СШТЕТËРОРЕ ПËР ВИТИН 2024



**SHKUP,
dhjetor, 2023**

Në bazë të nenit 19 të Ligjit të Ndërmarrjeve Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/96, 9/97, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18, 35/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 275/19 dhe 89/22) dhe nenit 20 të Statutit të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, Bordi Drejtues miratoi Programin vjetor për ndërtim, rikonstruim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore për vitin 2023:

HYRJE

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore është themeluar më 03.01.2013 me Vendim për themelim nr. 41-10147 / 1 nga data 28.12.2012, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 1 nga data 02.01.2013. Ndërmarrja Publike është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me numër NVAŠ 6839673 dhe e njëjta është pasardhëse ligjore e Agjencisë për Rrugë Shtetërore Shkup.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore e organizon punën e saj, planifikimin, zhvillimin dhe sigurimin e të hyrave në bazë të Programit vjetor për ndërtim, rikonstruim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore.

I

TË HYRAT E PLANIFIKUARA DHE TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA TË NDËRMARRJES PUBLIKE TË RRUGËVE SHTETËRORE PËR VITIN 2024

Të hyrat e planifikuara për vitin 2024 përfshijnë me Ligj burimet e parapara të financimit për kryerjen e veprimtarisë themelore të ndërmarrjes, të përcaktuara sipas Ligjin të Rrugëve Publike, edhe atë:

- 1) pjesë të akcizës nga derivatet e naftës;
- 2) kompensim për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore);
- 3) kompensim për përdorimin e rrugës publike, pjesë të saj ose e objektit në rrugë (taksa rrugore);
- 4) kompensim për:
 - a) vendosjen e mbishkrimeve dhe të tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
 - b) lidhja e rrugës hyrëse me rrugë shtetërore,
 - c) vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe në mbrojtëse të rrugës shtetërore,
 - ç) ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve tregtare në të cilat lejohet qasja në rrugë shtetërore jashtë vendbanimit;
 - d) përdorimi i tepruar i rrugës,
 - dh) transport i jashtëzakonshëm dhe
 - e) dëm i bërë në rrugë dhe objektet rrugore;
- 5) mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 6) huamarrje dhe kreditë dhe
- 7) të hyra të tjera

- Ilustrim tabelor i të hyrave të planifikuara dhe të ardhurave nga kreditë e huaja për vitin 2024

TË HYRAT DHE TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA	PROGRAMI I VITIT 2024
TË HYRAT	12,290,000,000
Pjesë e akcizës nga derivatet e naftës	5,500,000,000
Taksa rrugore	4,400,000,000
Regjistrimi (taksa rrugore nga regjistrimi)	2,300,000,000
Të hyrat tjera nga puna	90,000,000
TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA	9,445,000,000
Kredi nga Banka Botërore	1,800,000,000
Grant nga Banka Botërore	830,000,000
Kredi nga BERZH-I	3,715,000,000
Kredi nga Banka Eksim	3,100,000,000
Mjete nga Buxheti për vitin 2024 – për investime në infrastrukturën rrugore	15,100,000,000
Mjete të transferuara nga Buxheti për vitin 2023 për unvestime në infrastrukturën rrugore	1,695,871,044
GJITHSEJ	38,530,871,044

I.1 Në vitin 2024 planifikohet të realizohen të hyra në vlerë totale prej 12.290.000.000 denarëve, dhe atë:

I.1.1 Planifikohet të hyrat nga derivatet e naftës për vitin 2024 të jenë 5.500.000.000 denarë. Lartësia e këtyre të hyrave përcaktohet me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedoisë së Veriut dhe e njëjta nuk mund të jetë më e ulët se 30% nga të hyrat e

përgjithshme mbi bazë të akcizave të derivateve të naftës. Mjetet transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veirut në llogarinë e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore së paku 4 herë në vit, në interval së paku prej 3 muaj kalendarik.

I.1.2 Nga kompensimi për përdorimin e rrugës publike, pjesës së saj ose objektit të rrugës (taksa rrugore), priten të hyra prej **4.400.000.000 denarë**. Të hyrat e përgjithshme mbi këtë bazë llogariten sipas frekuencës së realizuar të trafikut sipas llojeve dhe kategorive të automjeteve në vitin 2023 dhe të hyrave të realizuara nga vitet e mëparshme dhe në përputhje me Vendimin për shumën dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për përdorimin e rrugës (taksës rrugore), ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 118/19).


I.1.3 Të hyrat e planifikuara nga kompensimi për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) që paguhet gjatë regjistrimit të automjeteve, janë **2,300,000,000 denarë**. Të hyrat janë planifikuar dhe realizohen në përputhje me Vendimin për shumën dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/09) dhe Vendimin për ndryshimin e Vendimit për shumën dhe mënyrën e pagimit të kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/14), si dhe në bazë të të hyrave të realizuara nga vitet paraprake mbi këtë bazë.

I.1.4 Të hyrat tjera nga puna në vitin 2024 pritet të jenë **90.000.000 denarë**, ndërsa planifikohet të realizohen nga kompensimet që paguhet në rrugët magjistrale dhe ato rajonale, dhe atë:

- vendosja e mbishkrimeve dhe e tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
- lidhja e rrugës hyrëse me rrugë shtetërore,
- vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe mbrojtës të rrugës shtetërore,
- ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve tregtare në të cilat lejohet qasja në rrugë shtetërore jashtë vendbanimit;
- përdorimi i tepruar i rrugës,

- transport i jashtëzakonshëm
- dëm i bërë në rrugë dhe objektet rrugore dhe të tjera.

➤ Ilustrim grafik i të hyrave të planifikuara për vitin 2024



I.2 Në vitin 2024 planifikohet të realizohen të ardhura nga kredi të huaja në vlerë të përgjithshme prej 9.445.000.000 denarëve, dhe atë:


I.2.1 Nga Banka Botërore, për financim të projekteve priten të ardhura prej 1.800.000.000 denarë,

1.2.2 Nga Grant nga Banka Evropiane për financim të projekteve priten të ardhura prej 830.000.000 denarë,

1.2.3 Nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim priten të ardhura prej 3.715.000.000 denarë,

1.2.4 Nga Banka Eksim, për vitin 2024 planifikohet të tërhiqen mjete në vlerë prej 3.100.000.000 denarë.

➤ Ilustrim grafik i të ardhurave të planifikuara nga kredi të huaja për vitin 2024



I.3 Në Buxhetin e RMV-së për vitin 2024 – Ministria e Transportit – Nënprogrami 2M – Investime në infrastrukturën rrugore – Subvencione kapitale për ndërmarrje dhe organizata joqeveritare janë paraparë 16.795.870.000 denarë për realizimin e projekteve në përputhje me Ligjin për përcaktimin e interesit publik dhe nominimin e partneritetit strategjik për zbatimin e Projektit për ndërtimin e Korridorit 8 të infrastrukturës (segmenti: Tetovë – Gostivar – Bukojçan dhe Projektit të autostradës Trebenishtë – Strugë – Qafë Thanë) dhe Koridori 10d (segmenti i autostradës Prilep – Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

II.

SHPENZIME TË PLANIFIKUARA, SHLYERJE TË KREDIVE DHE PROGRAMI I INVESTIMIT I NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE PËR VITIN 2024

Në vitin 2024, për investime, shlyerje të kredive dhe shpenzime, planifikohen mjete në vlerë totale prej 38,530,871,044 denarë.


➤ Ilustrim tabelor për investimet e planifikuara, shlyerjen e kredive dhe të shpenzime për vitin 2024

SHPENZIME, SHLYERJE TË KREDIVE DHE INVESTIME	PROGRAMI PËR VITIN 2024
SHPENZIME	3,340,000,000
1. Shpenzime për materiale harxhuese të zyrës, inventar i imët dhe karburant	30,000,000
2. Shërbime për mirëmbajtje të rrugëve, mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve, shërbime komunale dhe shërbime të tjera	1,850,000,000
3. Paga dhe kompensime të tjera për punonjësit	660,000,000

4. Transferim drejt NJVL-ve për mirëmbajtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave	300,000,000
5. Taksa, kthim të mjeteve nga regjistrimi, provizione bankare dhe shpenzime të tjera nga puna	500,000,000
SHLYERJA E NORMËS SË INTERESIT DHE KRYEGJËSË NGA KREDITË E MARRA	5,380,000,000
1. Shlyerja e normës së interesit për kreditë e marra nga kreditorët e huaj	900,000,000
2. Shlyerja e kryegjësë për kreditë e marra nga kreditorët e huaj	3,871,400,000
3. Shlyerje e borxhit të riprogramuar në MF	608,600,000
PROGRAMI I INVESTIMEVE	29,810,871,044
1. INVESTIME NGA MJETET VETANAKE	3,570,000,000
1.1 Ndërtim të rrugëve, ndriçim, sinjalizim, ura, tunele, rrëshqitje të tokës dhe pjesëmarrje vetanake në investime nga kreditë e huaja	1,850,000,000
1.1.1 Ndërtim të rrugëve	1,200,000,000
1.1.2 Sinjalizim dhe paisje rrugore	100,000,000
1.1.3 Rrëshqitje të tokës dhe rehabilitim të urave dhe tuneleve, dhe punime të tjera	100,000,000
1.1.4 Pjesëmarrje vetanake në investime me kredi të huaja	450,000,000
1.2. Mirëmbajtje investuese të rrugës	720,000,000
1.3. Shpronësim	300,000,000
1.4. Projektim dhe mbikëqyrje	650,000,000
1.5. Pajisje dhe softuer	50,000,000
1.6. Mjete buxhetore për ndërtimin e segmentit të autostradës: Tetovë – Gostivar – Bukojçan, dhe	16,795,871,044

Trebenishtë – Strugë – Qafë –Thanë, dhe Prilep – Manastir,	
2. INVESTIME NGA KREDI TË HUAJA	9,445,000,000
2.1. Kredi dhe Grant nga Banka Botërore	2,630,000,000
2.1.1. Projekt për avancimin dhe zhvillimin e rrugëve	2,630,000,000
2.2. Kreditë nga BERZH-i	3,715,000,000
2.2.1. Sistemi elektronik i pagesës së taksës rrugore Korridor 10	15.000.000
2.2.2. Projekt për ndërtimin e rrugëve nacionale	1,900,000,000
2.2.3 Projekt për rikonstruim dhe rehabilitimin e segmentit Kriva Pallankë- Deve Bair (kufiri me R. e Bullgarisë)	100.000.000
2.2.4 Projekt për taksë rrugore në Korridorin 8	300.000.000
2.2.5 Bukojçan-Kërçovë	400.000.000
2.2.6 Shkup- Bllacë	100.000.000
2.3. Kredi nga Banka Eksim	3,100,000,000
2.3.1 Projekt për ndërtimin e autostradës Kërçovë- Ohër	3,100,000,000
GJITHSEJ	38,530,871,044

- Ilustrim grafik i shpenzimeve të planifikuara, shlyerjes së kredive dhe investimeve në vitin 2024



II.1. Në vitin 2024 planifikohen shpenzime në vlerë totale prej 3.340.000.000 denarëve, dhe atë:

II.1.1 Për shpenzime të materialit shpenzues për zyra, inventar të imët dhe karburant janë planifikuar gjithsej 30.000.000 denarë. Këto shpenzime janë për prokurime të: tonerë për printerë dhe fotokopjues, letra për kase fiskale në stacionet pagesore, bileta paragon, letër për fotokopje, karburant për gjenerator rryme dhe automjete zyrtare, pajisjet MHT për punonjësit e stacioneve pagesore, mjete higjienike dhe shpenzime të tjera.

II.1.2 Për shërbime të mirëmbajtjes së rrugëve, mirëmbajtjes së objekteve dhe pajisjeve, shërbimet komunale dhe shërbimet e tjera, janë planifikuar gjithsej 1.850.000.000 denarë. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë planifikuar për mirëmbajtjen e rrugëve, përmes Kontratës me Ndërmarrjen Publike për Mirëmbajtjen dhe Mbrojtjen e Rrugëve Magjistrale dhe Rajonale. Përveç

mirëmbajtjes së rrugëve, ky zë përfshin edhe shërbime për mirëmbajtjen e ndërtesave, të objekteve, softuerëve dhe pajisjeve (ashensorë, fotokopjues dhe printerë, kondicionerë, automjete, gjeneratorë, qendra KZ, aparate KZ dhe testimin e instalimeve të mbrojtjes nga rrufetë, shtypës fiskalë, sistem për video vëzhgim dhe pajisje komunikimi të SP dhe pikave kufitare, sistemi i pagesës së taksave rrugore, etj), shërbime komunale, shërbime higjienike, energji elektrike, provizion për Shoqatat e kontrollit teknik, avokat, noter, shpenzimet e përmbaruesve dhe shërbime të tjera.


II.1.3 Për paga dhe kompensime të tjera për punonjësit (të përcaktuara me Ligj, akte nënligjore, kontrata kolektive, akte të ndërmarrjes dhe të ngjajshme) janë planifikuar gjithsej **660.000.000 denarë**. Këto mjete janë të parashikuara për pagimin e pagës bruto dhe kompensimeve të ndryshme për punonjësit.

II.1.4 Për transferim në NJVL-të për rikonstruim dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave, janë planifikuar mjete prej **300.000.000 denarë**. Mjetet transferohen në përputhje me Ligjin për rrugëve rublike tek Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale pas dorëzimit të Programit për vitin aktual dhe Raportit të punës për vitin paraprakë.

II.1.5 Për pagimin e tatimeve, kthimin e mjeteve nga regjistrimi, provizionet bankare dhe shpenzimet e tjera të punës janë planifikuar **500.000.000 denarë**. Në këtë grup bëjnë pjesë: Tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimin e mjeteve nga regjistrimi i automjeteve motorike dhe rimorkiove që kryejnë transport ndërkombëtar të mallrave, provizione bankare, stipendione dhe zhvillim profesional, si dhe shpenzime të tjera që dalin nga puna ditore (sigurimi i punonjësve dhe pronës, transporti i të

punësuarve, kontrolli sistematik, transferimi i shpejtë i dërgesave, kompensime për anëtarët e Bordit Drejtues dhe Bordit Mbikëqyrës, dhe të ngjajshme.)

➤ Ilustrim grafik i shpenzimeve vetanake në shpenzimet e përgjithshme të planifikuara për vitin 2024



II.2 Për shlyerjen e kredive ndaj Institucioneve Ndërkombëtare Financiare, janë planifikuar mjete në vlerë totale prej 5.380.000.000 denarë, për:

II.2.1. Për shlyerjen e normës së interesit për kreditë e marra nga kreditorët e huaj, parashihen mjete në vlerë prej 900.000.000 denarëve.

II.2.2. Në bazë të shlyerjes së kryegjësë për kreditë e marra nga kreditorët e huaj, janë planifikuar mjete në vlerë totale prej 3.871.400.000 denarëve.

II.2.3. Për shlyerjen e borxhit të riprogramuar ndaj Ministrisë së Financave janë planifikuar 608.600.000 denarë. Borxhi ndaj Ministrisë së Financave buron nga shlyerja e anuiteteve ndaj Bankës Eksim, të cilat për Ndërmarrjen Publike i ka kryer Ministria e Financave, dhe më pas janë lidhur marrëveshjet për riprogramimin e borxhit.

II.3. PROGRAMI I INVESTUES

Ndërmarrja Publike në vitin 2024 planifikon të realizojë mjete për investime në vlerë të përgjithshme prej 29.810.871.044 denarëve, edhe atë:

II.3.1 Për investime me mjete vetanake dhe buxhetore janë parashikuar 3.570.000.000 denarë.

II.3.1.1 Për ndërtim të rrugëve, rehabilitim, rikonstruimin, ndriçim, sinjalizim, pajisjet rrugore, urat, tunelet, rrëshqitjet e tokës, për pjesëmarrje vetanake në investime të financuara nga kreditorët e huaj dhe punë të tjera janë planifikuar 1.850.000.000 denarë.

Këto mjete janë të parashikuara për realizimin e projekteve në vijim:

- Projekte të përfunduara, ndërsa pagesa do të bëhet në vitin 2024:
- Rikonstruim i rrugës rajonale të R2133 segmenti Matejç - Likovë,
- Rindërtimi i rrugës rajonale krahu 1 të R-418 (faza 2), në drejtim të fabrikës "Vevçanka" - Shtëpia e shëndetit Vevçan,
- Ndërtimi i rrugës shtetërore R1402 segmenti F. Konjarevë e vjetër - . Konjarevë e Re,
- Rikonstruimi i rrugës shtetërore R2133 segmenti Ropalcë - Matejç
- Rikonstruimi i rrugës shtetërore R1109 segmenti, qarkorja në Bogdanci,

- Sanim i pbazës në rrugë në R1303, segmenti M.Brod – Prilep (Prevoj) Barbaros
- dhe projekte të tjera
 - **Projektet që do të vazhdojnë me realizimin në vitin 2024:**
 - Ndërtimi i autostradës A4, segmenti VK "Bllacë" - Shkup (nyja rrugore "Stenkovec"), nënsegmenti 1 - zgjerimi i rrugës ekzistuese A4 nga VK "Bllacë" deri në fshat. Bllacë në nivelin e autostradës dhe ndërtimin e një pjese të autostradës me nyje rrugore për t'u lidhur me rrugë lokale për në fshat. Bllacë,
 - Ndërtim i rrugës rajonale R2246, Izvor (lidhja me A2) – Ura e Garës,
 - Ndërtimi i autostradës Kërçovë – Ohër,
 - Rikonstruim i segmenit Strumicë – Dabile,
 - Rehabilitim dhe riparim të rrugës shtetërore R1301, segmenti Ohër – Shën Naum,
 - Kompletim i ndërtimit të autostradës A4, segmenti "Bllacë" – Shkup (nyja rrugore "Stenkovec"), nënsegmenti 1 – zgjerim i rrugës ekzistuese A4 nga VK "Bllacë" deri në fshat. Bllacë në nivelin e autostradës dhe ndërtimin e një pjese të autostradës me nyje rrugore për t'u lidhur me rrugë lokale për në fshat. Bllacë,
 - Riparim dhe rehabilitim të rrugëve shtetërore me marrëveshje korinizë nga viti 2022: segmenti, Demir Kapi – Negotinë (të dy korsitë), segmenti Shkup – Tetovë (të dy korsitë), segmenti Milladinovci – Sveti Nikollë, segmenti Shkup – Kumanovë (korsia e djathtë, segmenti Krivogashtan – Krushevë, segmenti Ropotovë – Llazhan edhe mbrojtje edhe sanim i murit mbajtës tek Bigorski,
 - Ndërtim i qarkores në Tetovë përmes nyjes rrugore Trebosh deri në Neproshten (faza 1),
 - Vendosje të Sinjalizimit të trafikut dhe pajisje në rrugën shtetërore A3 segmenti Bukovë – Ohër nënsegmenti Bukovë – hyrja në Ohër,
 - Vendosje e rrethojës mbrojtëse të zëshme në disa akse rrugore në gjatësi të Korridorit 8 dhe 10d (afër qytetit të Kumanovës dhe afër vendbanimit Saraj),

- Vendosje e Sinjalizimit të trafikut në rrugën shtetërore R1206, segmenti Zhelinë – Tetovë, segmenti nyja rrugore Saraj – Karpallak
- dhe projekte të tjera.

- **Projektet që do të fillojnë në vitin 2024:**

- Ndërtimi dhe zgjerimi me përmirësimin e elementeve gjeometrike të rrugës rajonale R2235, segmenti Nikiforovë - Leunovë - Bunec (kryqëzimi me R1202),
- Ndërtimi i një ure të re mbi lumin Pçinjë për të lidhur autostradën e ardhshme A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip (nyja rrugore Konjare e Mesme) me rrugën rajonale R2136,
- Rehabilitim me përmirësim të autostradës A1, VK Tabanovc – nyja rrugore Tabanovc,
- Rikonstruim me zhgjerim të rrugës rajonale R1109 segmenti Ponov Most – hyrja në Bogdanci,
- Ndërtim i qarkores në Tetovë përmes nyjes rrugore Trebosh deri në Neproshten (faza 2)
- Kompletimi i punimeve të papërfunduara për ndërtimin e autostradës A4, segmenti Milladinovc - Shën Nikollë - Shtip,
- Rehabilitimi i rrugës shtetërore A2, Qarkorja e Kriva Pallankës
- Rrindërtim i nyjes rrugore Brvenicë
- Riparimi dhe rehabilitimi i rrugëve shtetërore me marrëveshje kornizë
- Ndërtim dhe zgjerim me përmirësim të elementeve gjeometrike në rrugën rajonale R2235, segmenti Diga e Mavrovës – Kanali i Beliçit
- Ndërtim i drejtimit rrugor A1: Prilep – Gradsko, pjesa nga kryqëzimi me rrugën për në fshatin Bellovodicë deri te ura në Kamenollom Mavrovë,
- Ndërtim dhe përmirësim i elementeve gjeometrike të rrugës shtetërore nga kryqëzimi me autostradën A1 – Negotinë,

- Sanim të mureve mbrojtëse te nënkalimi në rrugën shtetërore A2, qarkorja e Shkupit në km. 21+840 deri në km. 21+987,
- Sanim të bazës në rrugë në R1306, segmenti Prilep – Krushevë (Te Sllavej),
- Sanim të rrëshqitjes së dheut / bazës së rrugës në km 49+800 në R1202, segmenti Kosovrast – Ura e Mellniçkit,
- Sanim të urës mbi lumin Vardar (në afërsi të fshat. Zdunje) në rrugën shtetërore A2, segmenti Gostivar Strazhë,
- Sanim i urës mbi lumin Shevnicë në R1101,
- Ndërtimi i urës në R2331, segmenti Manastir – Nizhe Polë,
- Sanim të bazës së rrugës në R1003, segmenti Makedonski Brod – Prilep (Prevoj) Barbaros,
- Sanim të rrëshqitjes së dheut/ shpateve në R1202, segmenti Ura Boshkov – Ura e Mellniçkit (afër Kosovrastit),
- Sanim (lyerje) e tunelit në autostradën A1, segmenti Demir Kapi – Smokvicë,
- Vendosje e sinjalizimit dhe pajisjeve të komunikacionit për të rritur sigurinë në komunikacion
- Vendosja e sinjalizimit të komunikacionit për drejtimin e trafikut në rrugët shtetërore në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve,
- Vendosja e gardhit mbrojtës të zërit në pjesë të caktuara të akseve rrugore në gjatësi të Korridorit 8 dhe 10 (pranë qytetit të Kumanovës, Konjare e Poshtme, Tabanovc dhe pranë Zhelinës),
- Vendosje e sinjalizimit të komunikacionit në rrugën shtetërore R1203, segmenti Tetovë – VK Jazhincë,
- Kompletim të ndërtimit të rrugës rajonale R2246, segmenti Izvor (lidhja me A2) – Ura e Garës,
- Marrëveshja kornizë për vendosje të sinjalizimit të komunikacionit dhe pajisjeve për rritjen e sigurisë në komunikacion në kohëzgjatje prej dy vite

- Vendosije e sinjalizimit të komunikacionit në rrugën shtetërore R2242, Zhelinë - Jegunovcë lidhja me R2234 dhe rrugën rajonale R2234 Jegunovcë - Tearcë,
- Marrëveshja kotnizë për sanim të rrëshqitjes së dheut dhe rrëshqitjeve në rrugët shtetërore
- Dhe projekte të tjera
 - Nëse sigurohen mjete në vitin 2024, planifikohet të fillojnë edhe projektet e mëposhtme:
- Ndërtim i rrugës eksprese Manastir - Mexhitli me qarkore në Manastir
- Ndërtim i rrugës shtetërore Strumicë - Vallandovë - kryqëzim me A1,
- Ndërtim i rrugës shtetërore A3 qarkore në Resnjë.
- Rehabilitim i autostradës Hipodrom - Milladinovci (të dyja korsitë)
- Rehabilitim i autostradës Petrovec - Milladinovci (të dyja korsitë),
- Rehabilitim i autostradës Hipodrom - Petrovec (të dyja korsitë),
- Rehabilitim i rrugës rajonale Krivogashtani -Krushevë
- Rehabilitim i rrugës rajonale Llopaticë - Slladuevë (Demir Hisar)
- Rehabilitim i rrugës rajonale Krushevë - Slladuevë (Demir Hisar),
- Rehabilitim i rrugës rajonale Slladuevë (Demir Hisar) - Drugovë (Kërçovë),
- Sanim i urës mbi lumin Bregallnicë në R1204 në Shtip,
- Sanim i rrëshqitjes së dheut në rrugën rajonale R2245, segmenti Kiselicë - Llukë,
- Ndërtim i rrugës rajonale R1210 segmenti Minierë Toranicë - Miniera Sasa (lidhja e Kriva Pallankës me Makedonska Kamenicë),
- Dhe projekte të tjera.

II.3.1.2 Për mirëmbajtjen investuese të rrugëve parashihen **720.000.000 denarë**. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve do të realizohen përmes Kontratës me Ndërmarrjen Publike për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale, të parashikuara në Programin Vjetor për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2024;

II.3.1.3 Për shpronësim të tokës, ndërtesave, pyjeve, plantacioneve dhe të mbjellave të segmentit që planifikohen për ndërtim gjatë vitit 2024, janë planifikuar 300.000.000 denarë;

II.3.1.4 Për përgatitjen e dokumentacionit të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve ndërtimore në rrugët shtetërore, parashikohen mjete në vlerë prej 650.000.000 denarë. Ky pozicion mbulon kostot për përgatitjen e studimeve të fizibiliteti, projekteve të infrastrukturës, studimeve të mjedisit jetësor, projekteve themelore dhe pjesëve të tjera të dokumentacionit tekniko-investues, siç është mbikëqyrja mbi ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve.

Në vitin 2024, planifikohet pagesa e kontratave tashmë të lidhura për përgatitjen e dokumentacionit projektues për segmentet e mëposhtme:

- Përgatitja e projektit infrastrukturor për rrugën shtetërore A2 segmenti Bukojçan - Kërçovë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues segmenti Strumicë - Vallandovë - lidhja me A1,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rrugën shtetërore A3 qarkore Resnjë,
- Ndërtimi i urës së re në lumin Pçinja për lidhjen e autostradës së re A4, segmenti Molladinovci - Sveti Nikollë – Shtip (nyja rrugore Konjare e mesme) me rrugën rajonale R2136
- Kompletim të dokumentacionit ekzistues të projektit dhe përgatitje të projektit infrastrukturor për rikonstruim me zgjerim të rrugës rajonale R2236 segmenti Sveti Nikollë
- Neokaz,

- Përgatitje të dokumentacionit projektues për ndërtim të qarkores në Tetovë përmes nyjes rrugore Trebosh deri në Neproshten (faza2),
 - Kompletimi i dokumentacionit ekzistues të projektit për ndërtim dhe zgjerim me përmirësim të elementeve gjeometrike në rrugën rajonale R2235 segmenti Nikoforovë – Leunovë – Bunec (lidhja me R1202),
 - Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitim të rrugës shtetërore A2, qarkorja në Kriva Pallankë,
 - Përgatitja e dokumentacionit teknik – Projekti i komunikacionit të rrugës shtetërore R1309 segmenti Zërnovcë – Koçan – Ponikvë,
 - Përgatitja e dokumentacionit projektues për sinjalizim të trafikut për drejtim të trafikut në rrugët shtetërore në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve,
 - Përgatitje e dokumentacionit projektues për Sanim të urës në R2250 segmenti, Kiselicë – Llukë,
 - Përgatitje e dokumentacionit teknik - Projekt i komunikacionit të rrugës shtetërore R1309 segmenti: Zletovë – Dobrevë – Probishtip dhe rruga shtetërore R2232 segmenti: lidhja R1309/2232 Ratavicë – Zletovë,
 - Përgatitje e dokumentacionit teknik – Projekt i komunikacionit të rrugës shtetërore R2242 Zhelinë – Jegunovc lidhja me R2234 dhe rruga rajonale R2234 Jegunovc – Tearcë.
- dhe projekte të tjera

Në vitin 2024 planifikohet përgatitja e dokumentacionit projektues për segmente të reja:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin dhe sanimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Demir Kapi - Negotinë (të dyja korsitë),
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për mbrojtjen e shpateve për autostradën A4, segmenti Milladinovc - Shën Nikollë - Shtip,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për pjesë të qarkores në Bogdanci në rrugën shtetërore R1109,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore Tetovë - Vendkalimi Kufitar Kosovë për në Prizren,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitim dhe sanim të rrugës shtetërore A1, segmenti nyja rrugore Gjevgjeli – VK Bogorodicë (korsa e djathtë),
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës eksprese, segmenti Strumicë – kufiri me R. e Bullgarisë.
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për zgjerimin e rrugës shtetërore A3, në lidhjen nga dy korsi në një, nga Delçeva për në fshatin Zvegor, për të përmirësuar sigurinë në trafik,
- Përgaditjen e dokumentacionit projektues për ndërtim e një ure në lumin Vardar afër fshtit Bashino, e cili është pjesë e rrugës rajonale R1312,
- Përgaditjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës rajonale R1106 segmenti. Breznicë e Re – Kulla – Kollomot ,
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për zgjerimin me përmirësim të elementeve gjeometrike në rrugën rajonale R2235, segmenti Diga Mavrovë – Beliçki kanal
- Përgaditjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore segmenti R1202, me qarkore në Dibër (njëkohësisht të kryeht procedura për kategorizim nga rrugë lokale në atë shtetërore),

- Përgaditjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore Strugë - Gorna Belica - Veveçani,

- Përgaditjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore Srezimir - Likovo Pole -Kufiri me Republikën e Kosovës (njëkohësisht të kryeht procedura për kategorizim nga rrugë lokale në atë shtetërore),

- Përgaditjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore Drenovë - Jabolçishtja e Epërme - Nezhillovë - kryqëzim me rrugën rajonale R2336 (njëkohësisht të kryeht procedura për kategorizim nga rrugë lokale në atë shtetërore),

- Përgaditjen e dokumentacionit projektues për mbrojtjen e shpateve në rrugën shtetërore R1202, segmenti Mavrovi anovi - Zhirovnicë,

- Përgatitje e dokumentacionit projektues për rehabilitim dhe sanim të rrugës shtetërore A2, segmenti Shkup - Tetovë (të dyja korsitë)

- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për rehabilitim dhe sanim të rrugës shtetërore A1, segmenti Negotinë - Stobi (të dyja korsitë)

- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për rehabilitim dhe sanim të rrugës shtetërore A1, segmenti Stobi - Gradsko (të dyja korsitë),

- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për rehabilitim dhe sanim të rrugës shtetërore A1, segmenti Gradsko - Veles (të dy korsitë),

- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për rehabilitim dhe sanim të rrugës rajonale R1310 segmenti Berovë - VK Klepalo,

-Kompletim të dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës rajonale R1107 segmenti Rozhden - Majden - VK Pulevec,

- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për rindërtim të nyjes rrugore Bërvenicë,
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për plotësimin e projektit bazë dhe projektit për infrastrukturë për ndryshim dhe plotësim të projektit të infrastrukturës për ndërtimin e rrugës shtetërore R2246, segmenti Ura e Garës – Ehlovec (Izvor),
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për sanimin e rrëshqitjes së dheut në rrugën magjistrale A3, segmenti Ista Banja – diga Kalimancit (mbi fshatin Istibanjë),
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për sanim të urës në Zhirovnicë në km30+626,
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore qarkorja në Novaci, (njëkohësisht të kryeht procedura për kategorizim nga rrugë lokale në atë shtetërore),
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për çasje në tre pika të benzinit në autostradën A1 segmenti VK Tabanovcë – kumanovë,
- Përgatitje e dokumentacionit projektues për ndërtimin e nyjes rrugore “Ginovci” në rrugë shtetërore A2, segmenti Dllaboçicë – Stracin (Çatall) në nivel të autostradës,
- Përgatitje e dokumentacionit projektues – Sanim të rrëshqitjes së dheut në rrugën Shën. Joakim Osogovski, Komuna Kriva Pallankë,
- Përgatitje e dokumentacionit projektues – Sanimtë rrëshqitjes së dheut në rrugën e vjetër të Manastirit, Komuna Kriva Pallankë,
- Përgatitje e dokumentacionit projektues Sanimtë rrëshqitjes së dheut në rrugën rajonale R2245, segmenti Kiselicë – Llukë,
- Përgatitje e dokumentacionit projektues me zgjërime dhe përmirësim të sigurisë së trafikut në rrugën shtetërore R2234, segmenti Kondovë – Radushë – Jegunovc dhe ndërtim të qarkores në Svillare,

- dhe projekte të tjera

Nëse sigurohen mjete në vitin 2024, planifikohet të fillojnë projektet e mëposhtme:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për kryqëzimin e rrugës eksprese A2, segmenti Kriva Pallanka – kryqëzim me rrugën magjistrale ekzistuese,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës eksprese në rrugën shtetërore A3, segmenti Koçani – Delçevë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës eksprese në rrugën shtetërore A3, segmenti Trebenishtë – Kosel - Resnjë
- dhe projekte të tjera

II.3.1.5 Për prokurimin e pajisjeve dhe softuerëve janë planifikuar 50.000.000denarë.

II.3.2. Për investime nga kredi të huaja janë planifikuar 9.445.000.000 denarë dhe të financuara nga: Banka Botërore, Banka Evropiane për rindërtim dhe Zhvillim dhe Eksim Banka.

II.3.2.1 Kredi dhe Grante nga Banka Botërore në vlerë prej 2.630.000.000 denarë, për projektet në vijim:

- Me projektin për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve, të financuara me grant mjete të siguruara nga Bashkimi Evropian WBIF dhe kredi nga Banka Botërore:
 - Ndërtim i rrugës eksprese Rankovcë – Kriva Pallankë,
 - Shërbimet e konsulencës: Asistencë e NPRRSH për aktivitetet përgatitore për instalimin e një sistemi të menaxhimit me urat,
 - Shërbimet e konsulencës: Hulumtimin Ex-ante dhe Ex post hulumtim konsumatori dhe vlerësimë i ndikimit
 - Auditim teknik gjatë ndërtimit të rrugës eksprese Rankovcë – Kriva Pallankë,

- Ekspert i kushteve të marrëveshjes dhe furnizimeve
- Hardueri dhe softueri i Sistemit të menaxhimit me ura (BMS),
- Shërbime konsulence për kontrollimin e gjendjes së urave,
- Shërbime konsulence – furnizim dhe instalim i një moduli analitik për urat BMS,
- Konsulent gjeoteknik,
- dhe projekte të tjera

II.3.2.2 Kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë prej 3.715.000.000 denarë, për projektet në vijim:

- Projekti Ndërtim të pikave pagesore në Korridorin 10 dhe instalim të sistemit elektronik për pagesë të taksës rrugore faza e parë i referohet pikave taksave rrugore në vijim: Romanovcë, Petrovec, Sopot, Otovoca, Gradsko, Demir Kapi, Gjevgjeli dhe qendra e kontrollit për pagesë të taksës rrugore Petrovec. Të gjitha taksat rrugore të cilat janë pjesë e kontratës si dhe qendra e kontrollit në Petrovec janë ndërtuar, ndërsa në vitin 2024 do të vazhdojë pagesa për mirëmbajtjen e sistemit për pagesë elektronike (mirëmbajtja është pjesë e kësaj kontrate).
- Me Programin e Projektit për Rrugët Nacionale, do të financohen:
 - Ndërtimi i rrugës eksprese Shtip – Koçan (Segmenti Shtip – Krupishtë dhe Segmenti Krupishtë – koçan kanë përfunduar, ndërsa për Segmentin Krupishtë – Koçan do të ketë implikime financiare në vitin 2024),
 - Ndërtim i rrugës eksprese Gradsko – Prilep, segmenti (Farish – Drenovë),
 - Rehabilitim në disa rrugë shtetërore: Katllanovë – Petrovec (2 kors), Hanet e Mavrovës – Zhirovnica është e përfunduar, do të ketë implikime në vitin 2024,
 - Rehabilitim i 5 rrugëve: Shkup – Bllacë, Podmolje – Strugë – Qafë Thanë, është e përfunduar, do të ketë implikime financiare në vitin 2024, Manastir – Mexhitli është i përfunduar, do të ketë implikime financiare në vitin 2024 dhe Veles – Gradsko.

- Rehabilitim i rrugës rajonale Krivogashtani – Krushevë,
 - Ndhmë teknike për Njësinë e implementimit të projektit,
 - Dhe projekte të tjera
- **Me Projektin Kriva Pallankë – Deve Bair**, me grante të siguruara nga Bashkimi Evropian dhe huamarrje nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe rehabilitim të drejtimit Kriva Pallankë – Deve Bair.
 - Asistencë teknike
 - **Projekti i taksave rrugore të autostradës**, financohet për instalimin e një sistemi elektronik të pagesës së taksës rrugore në Korridorin 8 dhe ndërtimin e pikave të reja pagesore në segmentet e autostradës të saponërtuar.

Me projektin ndërtim dhe instalim të sistemit elektronik për pagesë të taksës rrugore faza e dytë, në Korridorin 8 dhe autostradën Milladinovci – Shtip në vitin 2024 do të financohet rikonstruimi i pikave pagesore Gllumovë – Zhelinë, rikonstruim me një kors shtesë për pikë pagesore Milladinovci, si dhe mirëmbajtjen e pikave pagesore Preod hde Kadrifakovë. Në plan si pjesë e kësaj marrëveshjeje janë pikat pagesore Tetovë dhe Gostivar dhe instalim i sistemit fotovolltaik në të gjitha pikat pagesore ekzistuese në Korridorin 10 si dhe pikat pagesore të ndërtuara dhe të rikonstruara në Korridorin 9 dhe në autostradën Milladinovci – Shtip. Shërbime konsulente për mbështetjen e projektit për Ndërtimin dhe instalimin e pikave pagesore në Korridorin 8 dhe Autostradën Milladinovci – Shtip (faza e 2).

- **Ndërtimi i autostradës Bukojçan – Kërçovë**, finanohet me grante të siguruara nga Banka Evropiane dhe huamarrje nga Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim.
 - Përgatitja e projektit bazë për ndërtimin e autostradës, Bukojçan – Kërçovë, segmenti Cërvici – Strogomishtë e poshtme.
 - Mbikëqyrje mbi ndërtimin e autostradës Bukojçan – Kërçovë,

-Asistencë teknike

-dhe projekte të tjera

- **Ndërtimi i autostradës Shkup – Bllacë faza e dytë**, financohet me grant mjete të siguruara nga Bashkimi Evropian dhe huamarrje nga Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim.

-Mbikëqyrje të ndërtimit të autostradës **Shkup – Bllacë**,

-Asistencë teknike


-dhe projekte të tjera

II.3.2.4 Kredi nga Eksim Banka në vlerë prej 3.100.000.000 denarë, për financim të:

-Ndërtim të autostradës Kërçovë – Ohër

III.3.3. Për implementim të projektit për ndërtim të Korridorit 8 infrastrukturor (segmenti: Tetovë – Gostivar – Bukojčan dhe Projektit të autostradës Trebenishtë – Strugë – Qafë Thanë) dhe Korridori 10d (segmenti i autostradës Prilep – Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, janë paraparë **16.795.870.000 denarë** në Buxhetin e RMV për vitin 2024 – Ministria e Transportit – Investime në infrastrukturën rrugore – Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare.

- Ilustrim tabelor i investimeve të planifikuara në vitin 2024



III.

Ky Program hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, ndërsa do të fillojë të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

BORDI DREJTUES I NP për RRUGË SHTETËRORE

KRYETAR

БЛАГОЈЧЕ СТОЈЧЕ

